



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2023:008531  
Datë: 30.01.2024  
Numri i dokumentit: 05258711

Ac.nr.6812/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gshi Alaj, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Fatmir Baloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.G nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B.K dhe F.G, të dy avokatë nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit -Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.M avokat nga Prizreni, për shkak të kompensimit të shujtave, vlera e kontestit 306.00 euro (treqind e gjashtë), duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.4421/2022, i datës 21.07.2023 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 29.01.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.4421/2022, i datës 21.07.2023 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.4421/22, i datës 21.07.2023 ka vendosur si në vijim:

*“APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.G nga Prizreni, DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditëses S.G nga Prizreni, në emër të shujtave ditore për 153 ditë pune (për periudhën prej datës 01.01.2022 deri më datën 15.11.2022), ti paguaj shumën e përgjithshme prej 306,00 € (treqind e gjashtë), me*

*kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 11.01.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.*

*II. DETYROHET e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124 (njëqind e njëzetë e katër) euro, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.”*

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e parashtruar nga e paditura si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe ta hedhë poshtë padinë e paditëses apo ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar ose aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen kontestuese t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Palës paditëse i është dorëzuar ankesa me datë 10.08.2023 por e njëjta nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 12.01.2023, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, pa shqyrtim të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4421/2022, i datës 21.07.2023 me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën, ku ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune në SHFMU “H.”, në ..., Prizren dhe gjatë vitit 2022, nga data 01.01.2022 deri me datën 15.11.2022 i ka gjithsej 153 ditë pune. Në rastin konkret, gjykata thekson se duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021. Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, rrjedhimisht gjykata ka vlerësuar se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtoresh të arsimit t'ia paguaj kompensimin e

shujtave konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e në kuptim të Nenit 35 paragrafi 7, gjykata ka konstatuar se pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigje në padi, Gjkata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 ,452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë shumë prej 104 euro dhe taksës gjyqësore shumë prej 20 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme 124 euro.

Gjkata vendimin e saj e mbështeti në dispozitat e nenit 152 të LPK-së, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjkata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjkata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjkata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditëseve dhe nuk ka bërë tejkallim të kërkesëpadisë.

Gjkata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën, përkatësisht në SHFMU "H." në ..., Prizren. Po ashtu nuk janë kontestuese ditët e pranisë së paditëses në punë, e për të cilën periudhë kohore kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit - shujtës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes”*. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”*. Me paragrafin 5 përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”*. Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: *“Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim”*. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: *“MASHT, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore drejtë është bazuar në nenin 152 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadsisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditëses në emër të pagesës për kompensimin e shujtave gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditësve t’iu paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.6812/2023, datë 29.01.2024

Kryetare e kolegjit

Hidajete Gashi Alaj, d.v.